



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë



## MANUAL UDHËZUES

PËR LIÇENSIMIN E PILOTËVE TË PARAGLAJDEVE DHE DELTAPLANEVE

Nëntor 2018

## Hyrje

Ky dokument është pronë e:

### **Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë**

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1  
Pranë Parkut të Delegacioneve  
Tiranë / Shqipëri  
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjës in përgjegjë.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

**Drejt看 Ekzekutiv**

## PARATHËNIE

Ky manual është hartuar duke pasur parasysh parashikimet e Ligjit Nr. 10040, datë 22/12/2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave si dhe Urdhrin e Ministrit të Transportit 250 datë 12/09/2014 "Për Kërkesat Teknike dhe Procedurat Administrative në Lidhje me Ekuipazhin Ajror të Aviacionit Civil", Pjesa IV Pjesa Mjeksores.

### **Qëllimi i dokumentit**

Qëllimi i Manualit Udhëzues është të njoftojë aplikantët për kërkesat e detyrueshme dhe procedurat udhëzuese që aplikohet për lëshimin e licensave për pilotë të paraglaajdeve dhe deltaplaneve (dhe kategorizimet, autorizimet, certifikatat përkatëse që i shoqërojnë) si edhe trajnimet që kërkohen për to. Në këtë manual janë të përshkruara edhe kërkesat që duhet të pëmbushin pilotët mbajtës të licensave të huaja për vleftësimin, ose konvertimin e tyre.

***Shënim sqarues për aplikantët:** Përkufizimi në Urdhrin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave" i termit "Parashutë" përkon me "Paraglajd". Për këtë arsye në procedurat e mëposhtme referencat e mjetit ajror me përkufizimin "parashutë", do të përdoren për termin "Paraglajd".*



LISTA E FAQEVE EKZISTUESE

Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë		Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë
<u>I</u>	<u>12</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>FRM4</u>	<u>46</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>I</u>	<u>13</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>FRM4</u>	<u>47</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>I</u>	<u>14</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>FRM5</u>	<u>48</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>I</u>	<u>15</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>FRM5</u>	<u>49</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>I</u>	<u>16</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>FRM6</u>	<u>50</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>II</u>	<u>17</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>FRM6</u>	<u>51</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>II</u>	<u>18</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL1</u>	<u>54</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>II</u>	<u>19</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL1</u>	<u>55</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>II</u>	<u>20</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL1</u>	<u>56</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>III</u>	<u>21</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL2</u>	<u>57</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>III</u>	<u>22</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL2</u>	<u>58</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>III</u>	<u>23</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL2</u>	<u>59</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>III</u>	<u>24</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL3</u>	<u>60</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>IV</u>	<u>25</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL3</u>	<u>61</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>IV</u>	<u>26</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL4</u>	<u>62</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>IV</u>	<u>27</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL4</u>	<u>63</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>IV</u>	<u>28</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL5</u>	<u>64</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>V</u>	<u>29</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL5</u>	<u>65</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>V</u>	<u>30</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL6</u>	<u>66</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>V</u>	<u>31</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>		<u>CHKL6</u>	<u>67</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>
<u>V</u>	<u>32</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VI</u>	<u>33</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VI</u>	<u>34</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VI</u>	<u>35</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VII</u>	<u>36</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VII</u>	<u>37</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VIII</u>	<u>38</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VII</u>	<u>39</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>VII</u>	<u>40</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>FRM1</u>	<u>41</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>FRM2</u>	<u>42</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>FRM2</u>	<u>43</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>FRM3</u>	<u>44</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					
<u>FRM3</u>	<u>45</u>	<u>0</u>	<u>21.11.18</u>					



	Emri Mbiemri	Pozicioni	Datë	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Majlinda Hoxha	Inspektore e Licensimit të Personelit Ajror	21.11.2018	
Kontrolluar për përputhshmërinë nga:	Edlira Kraja	Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit dhe Standardizimit Teknik	17.12.2018	
Pranuar nga:	Elton Kacagjeli	I ngarkuar me DAMO	17.12.2018	
Kontrolluar për cilësinë nga:	Selma Pagria	Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit dhe Ruajtjes së cilësisë	17.12.2018	
Miraturar nga:	Krislen Keri	Drejtor Ekzekutiv	18.12.2018	

REGJISTËR I RISHIKIMEVE

Nr:	Datë:	Rishikuar nga:	Miraturar nga:
1			
2			
3			
4			

## PËRKUFIZIME

Për qëllimin e këtij manuali, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

*"Çertifikatë për kryerjen e trajnimit"* - nënkupton çertifikatën që organizata e miratuar e trajnimit, i lëshon pilotit student për kryerjen e trajnimit teorik dhe/apo praktik;

*"Deltaplan"* - nënkupton glajderin që është në gjendje të bartet, të nisët (lëshohet) me këmbë dhe të ulet vetëm duke shfrytëzuar këmbët e pilotit;

*"Deltaplan apo paraglajd dy-vendësh (Tandem)"* - nënkupton deltaplanin apo paraglajdin të destinuar për fluturim të njëkohshëm të dy personave;

*"Deltaplan me motor"* - nënkupton deltaplanin i cili ka të montuara mjete të forcës shtytëse që mundësojnë nisjen dhe mbështetjen e tij në fluturim, përfshirë edhe ato me rrota (trike);

*"Ekzaminues"* - nënkupton personin që drejton provimin praktik në lidhje me lëshimin e licencës, kategorizimit, për të drejtuar deltaplanin apo paraglajdin, në përputhje me standardet e përcaktuar nga AAC-ja;

*"Fluturim në distancë" (Cross-Country)* - nënkupton llojin e fluturimit në distancë, i cili kryhet me avion me motor në segmente përgjatë distancës së dhënë dhe në operime ndërmjet dy ose më shumë pikave duke përdorur teknika të navigimit; dhe me avion pa motor (paraglajd, deltaplan) duke përdorur rrymat ngritëse për të fituar lartësinë për një fluturim me kohë të zgjatur;

*"I/e miratuar"* do të thotë i/e miratuar me aktin përkatës të autoritetit kompetent si i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

*"I/e pranuar/i pranueshëm"* - do të thotë i pranuar nga autoriteti kompetent për këtë qëllim, si i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

*"Instruktor i autorizuar i fluturimit"* - nënkupton pilotin e deltaplanit apo paraglajdit me kategorizimin e vlefshëm të instruktorit të fluturimit, që operon në kuadër të organizatës së aprovuar për trajnimin e pilotëve të deltaplanëve apo paraglajdëve;

*"Kategorizim"* - nënkupton dëshminë e trajnimit shtesë të pilotëve të deltaplanëve apo paraglajdëve, e cila është e regjistruar në licencën e pilotit;



*"Kohë e instruksionit të dyfishtë"* - nënkupton kohën e fluturimit, ose kohën e fluturimit të simuluar në tokë gjatë së cilës personi kryen trajnim të fluturimit nga një instruktor i autorizuar në mënyrë të duhur;

*"Kohë e fluturimit"* - nënkupton kohën e përgjithshme nga momenti i lëvizjes së parë të avionit për qëllim të ngritjes deri në momentin kur ai përfundimisht ndalet në fund të fluturimit;

*"Lëshim (p.sh. i licencës apo kategorizimit të pilotit)"* - nënkupton procedurën administrative për pajisjen e pilotit me licencë apo kategorizim, e cila i lejon mbajtësit të licencës dhe/ose kategorizimit t'i ushtrojë privilegjet e përshkruara në të për një periudhë të caktuar kohore, pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara;

*"Librezë e fluturimeve"* - nënkupton regjistrin personal të fluturimeve të pilotit apo pilotit student të deltaplanëve apo paraglajdëve;

*"Licencë e pilotit - (deltaplan apo paraglajd)"* - nënkupton dokumentin i cili i mundëson mbajtësit të tij të kryejë detyrat e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit në përputhje me kategorizimet e shkruara në licencë, sipas llojit të licencës në zotërim;

*"Paraglajd"* - nënkupton deltaplanin, pa konstruktion themelor të ngurtë;

*"Paraglajd me motor"* - nënkupton paraglajdin me mjete të forcës shtytëse që janë në gjendje për t'a nisur atë dhe për t'a mbajtur në fluturim;

*"Pilot student"* - nënkupton personin i cili kualifikohet si kandidat për marrjen e licencës së pilotit për deltaplan apo paraglajd, ose kategorizimit;

*"Pilot testues"* - nënkupton një pilot i cili fluturon në një avion të një prodhimi të ri ose eksperimental për të testuar operimet e tij;

*"Regjistri i trajnimit"* - nënkupton regjistrin personal të pilotëve studentë në të cilin ata kanë futur lëndët e mësimi dhe vërtetimet në kursin e trajnimit;

*"Rinovim (p.sh. i kategorizimit apo miratimit)"* - nënkupton procedurën administrative të ndërmarrë pasi kategorizimi apo miratimi të ketë skaduar, e cila i ripërtërin privilegjet e kategorizimit apo miratimit për një periudhë të caktuar pasuese pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara;

*"Rivlefhtësim" (p.sh. i kategorizimit apo miratimit)* - nënkupton procedurën administrative të ndërmarrë brenda periudhës së vlefshmërisë së kategorizimit apo miratimit që i



lejon mbajtësit vazhdimin e ushtrimit të privilegjeve të kategorizimit apo miratimit për një periudhë të caktuar pasuese pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara;

*“Trajnim i miratuar”*-do të thotë trajnimi i cili kryhet sipas programit dhe mbikëqyrjes së veçantë të miratuar nga AAC-ja;

*Vleftësim i Liçensës së huaj* – nënkupton procesin administrativ të AAC-së, si alternativë e lëshimit të licensës së saj shqiptare, me anë të pranimit të një license të huaj të lëshuar nga një shtet tjetër si ekuivalente të licensës së saj .

### SHKURTIME

*Në këtë manual do të përdoren shkurtimet e mëposhtëme, të cilat do të nënkuptojnë:*

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë
RSH	Republika e Shqipërisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
DE	Drejtor Ekzekutiv
DAMO	Drejtoria e Mbikëqyrjes së Operatoreve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes
FCL	Liçensimi i Ekuipazhit Fluturues
LAPL	Liçensa e Pilotit të Avionit të Lehtë
I	Instruktor
T	Tandem (mjet dy vendësh)
A	Akrobatik
D	Pilot testues
GAT	Trafiku i Aviacionit të Përgjithshëm

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje .....	2
Parathënia .....	3
Lista e Faqeve Efektive .....	4
Lista e Shpërndarjes* .....	5
Tabela e rishikimeve .....	5
Termat dhe Definicionet / Shkurtime*/ Shpjegimi i Simboleve.....	6-9
Tabela e përmbajtjes .....	10-11
Kapitulli I-Lëshimi i Licensës së pilotit të Paraglajdit dhe Deltaplanit.....	12-16
Kapitulli II-Lëshimi i Kategorizimit të Instruktorit Për Pilotë Të Paraglajdit Dhe Deltaplanit.....	17-20
Kapitulli III- Lëshimi i kategorizimit Tandem (Mjetit Dyvendësh) për pilotë të Paraglajdit dhe deltaplanit .....	21-24
Kapitulli IV- Lëshimi i kategorizimit të pilotit testues (T) për pilotë të paraglajdit dhe deltaplanit. ....	25-28
Kapitulli V-Lëshimi i Kategorizimit Akrobatik (a) për pilotë të paraglajdit dhe deltaplanit .....	29-32
Kapitulli VI- Miratimi/Pranimi i Ekzaminuesit për zhvillimin e provimeve praktike .....	33-35
Kapitulli VII-Vleftësimi i Licensës së Huaj për Pilotë të paraglajdit dhe deltaplanit dhe kategorizimeve përkatëse .....	36-37
Kapitulli VIII-Konvertimi i Licensës së Huaj Për Pilotë Të paraglajdit dhe deltaplanit dhe kategorizimeve përkatëse .....	



---

.....	38-40
Forma DAMO-GAT-FRM-01.....	41-42
Forma DAMO-GAT-FRM- 02.....	42-43
Forma DAMO-GAT-FRM- 03 .....	44-47
Forma DAMO-GAT-FRM- 04.....	48-49
Forma DAMO-GAT-FRM- 05 .....	50-51
Forma DAMO-GAT-FRM- 06.....	52-53
List-Kontrolli DAMO-GAT-CHK- 01 .....	54-56
List-Kontrolli DAMO-GAT-CHK- 02.....	57-59
List-Kontrolli DAMO-GAT-CHK- 03 .....	60-61
List-Kontrolli DAMO-GAT-CHK- 04 .....	62-63
List-Kontrolli DAMO-GAT-CHK- 05.....	64-65
List-Kontrolli DAMO-GAT-CHK- 06.....	66-67

# Kapitulli I

## LËSHIMI LICENSES SË PILOTIT TË PARASHUTË (PARAGLAJD) DHE DELTAPLAN

## **Kërkesat bazë për përfitim të Licensës së Paraglajdit dhe Deltaplanit**

Për përfitim të licensës së paraglajdit dhe deltaplanit, pavarësisht nga tipi i mjetit me të cilin do të fluturojnë, aplikantët duhet të plotësojnë kërkesat bazë të cilat përcaktohen në Urdhrin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave si dhe Urdhrin e Ministrit Nr. 250, datë 12/09/2014 "Për Kërkesat Teknike dhe Procedurat Administrative në Lidhje me Ekuipazhin Ajror të Aviacionit Civil", Pjesa IV, Pjesa Mjekësore.

### **Vazhdimësia e vlefshmërisë së licencave**

1. Licencat e pilotëve për deltaplane dhe paraglajdeve lëshohen pa datë skadence.
  2. Zotëruesi i licensës ka të drejtën për të përdorur privilegjet e dhëna nga licenca e pilotit për deltaplan/paraglajd, nëse gjatë 24 muajve të fundit ai ka përfunduar të paktën 8 orë kohë fluturimi dhe 15 shkëputje dhe ulje.
- Nëse piloti i deltaplanit ose paraglajdit nuk përmbush kërkesat e specifikuara në paragrafin 2, më sipër, para marrjes së privilegjeve ai/a jo duhet të kalojë testin e aftësive (fluturimit) nën mbikëqyrjen e një Ekzaminuesi fluturimi përkatësisht të paraglajdit/deltaplanit.

### **1. Mosha minimale për licensë**

Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e licensës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit, kandidati duhet të jetë së paku 16 vjeç.

### **2. Privilegjet dhe kushtet**

Privilegj i mbajtësit të licensës së pilotit të paraglajdit/deltaplanit është drejtimi i pavarur i paraglajdit/deltaplanit për fluturime jo tregtare.

Për ushtrimin e privilegjeve, piloti i paraglajdit/deltaplanit duhet të mbajë një certifikatë të vlefshme mjekësore LAPL, (për licensa të pilotëve të avionëve të lehtë), sipas parashikimeve të Urdhrit të Ministrit Nr. 250, datë 12/09/2014 "Për Kërkesat



Teknike dhe Procedurat Administrative në Lidhje me Ekuipazhin Ajror të Aviacionit Civil”, Pjesa IV Pjesa Mjekstore.

Kandidati që kërkon licencën e pilotit për deltaplan apo paraglajd duhet t’i ketë së paku 10 orë kohë të përgjithshme të fluturimit si pilot student në deltaplan apo paraglajd, duke përfshirë së paku:

- a) 60 fluturime të suksesshme, secili nga ta me kohëzgjatje më të madhe se 5 minuta,
- b) 3 fluturime nga të cilët secili me kohëzgjatje prej së paku 2 orëve.

### **3. Kërkesat e Trajnimit**

Kërkesat e trajnimit ndryshojnë në varësi të mjetit ajror për të cilin kërkohet licensa. Temat e trajnimit për paraglajd dhe deltaplan janë të përshkruara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave”.

Gjithësesi, në të gjitha rastet aplikantët duhet të kenë kryer me sukses trajnimet teorike dhe praktike (fluturuese), në një organizatë/shkollë trajnimi të aprovuar nga AAC, për këtë qëllim.

Në rast të kryerjes së trajnimeve në një organizatë/shkollë jashtë Shqipërisë, aplikantët duhet të mbajnë parasysh që AAC do të pranojë trajnimet e kryera vetëm nga organizata/shkolla, të cilat janë aprovuar nga Autoriteti/Enti lëshues i licensave relevante në shtetin përkatës, mbi bazë të përputhshmërisë së programit të trajnimit me kërkesat e parapara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave”.

### **4. Provimi Teorik**

Pas përfundimit të trajnimeve teorike, aplikantët duhet të kalojnë provimin teorik, i cili organizohet në AAC, në lëndët:

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)
- b) Konstruksioni dhe materialet
- c) Meteorologjia
- d) Rregullat dhe legjislacioni
- e) Teknikat e fluturimit
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme
- g) Dhënia e ndihmës së parë.

## 5. Provimi praktik (skill test)

Pas përfundimit me sukses të provimit teorik, kandidati do t'i nënshtrohet provimit praktik, i cili do të drejtohet nga një Ekzaminues i autorizuar/pranuar nga AAC (shih kapitullin për Ekzaminuesit), jo më vonë se 12 muaj nga përfundimi i provimit teorik.

## 6. Aplikimi

- I. Për provimin teorik dhe praktik aplikanti për Licensë do të dorëzojë në AAC, formën e aplikimit DAMO-GAT-FRM-01
- II. Për përfundim të Licensës së Paraglajd/Deltaplanit, aplikanti do të dorëzojë në AAC, formën e aplikimit për Lëshimin e Licensës së Pilotit Deltaplan / Paraglajd, DAMO-FCL-FRM-01
- III. Së bashku me formën e aplikimit do të bashkëlidhen dokumentet:
  - Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit teorik për marrjen e Licensës së Pilotit për Deltaplan/Paraglajd.
  - Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit praktik sipas listës kontrolluese përkatëse të firmosura nga Ekzaminuesi i aprovuar/pranuar nga AAC, të cilat paraqiten në:
    - DAMO-GAT-CHK-01 "Lista kontrolluese për testin praktik për paraglajd"
    - DAMO-GAT-CHK-02 "Lista kontrolluese për testin praktik për deltaplan"
  - Kopje e Librezës së Fluturimeve të Pilotit ose Libreza e Fluturimeve të Instruktorit të fluturimit me pilotin aplikant.
  - Nëse aplikanti ka kryer trajnimin teorik dhe praktik në një organizatë/shkollë të huaj sipas pikes 3, më sipër, në AAC, do të dorëzohet vërtetimi/certifikata e përfundimit me sukses të trajnimit nga organizata/shkolla e huaj (me detaje të trajnimit).
  - Kopje e pashaportës



- Certificate mjeksore LAPL
- Vertetimi i pageses per AAC
- Dy foto 25 x 35 mm

#### **7. Paraqitja e dokumenteve në AAC, për vazhdimësinë e vlefshmërisë së licensave**

Për ruajtjen e privilegjeve të licensës, pilotët e deltaplaneve/paraglajdeve, do të paraqesin në AAC, çdo 24 muaj:

- librezën e fluturimeve, për të provuar që gjatë kësaj periudhe ka kryer të paktën 8 orë kohë fluturimi dhe 15 shkëputje dhe ulje.
- Certifikatën e vlefshme mjekësore

Nëse piloti i deltaplanit ose paraglajdit nuk përmbush kërkesat e specifikuara më sipër, për të rifituar privilegjet e ushtrimit të licenses, ai/ajo duhet të dorëzojë në AAC:

- testin përkatës të aftësive të (fluturimit) nën mbikëqyrjen e një Ekzaminuesi të aprovuar/pranuar nga AAC, sipas:
  - DAMO-GAT-CHK-01 "Lista kontrolluese për testin praktik për paraglajd"
  - DAMO-GAT-CHK-02 "Lista kontrolluese për testin praktik për deltaplan"



## Kapitulli II

### LËSHIMI I KATEGORIZIMIT TË INSTRUKTORIT PËR PILOTË TË PARASHUTËS (PARAGLAJDIT) DHE DELTAPLANIT

## **1. Mosha minimale**

Të paktën 18 vjeç.

## **2. Privilegjet**

Privilegji i mbajtësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit me kategorizimin e instruktorit të fluturimit kufizohet në kryerjen e trajnimit teorik dhe praktik (fluturimit) për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit dhe kategorizimeve përkatëse, nëse ai ka në licensën e tij ato kategorizimeve për të cilat instrukton.

Ushtrimi i privilegjeve të instruktorit mund të kryhet përkundrejt pagesës, për trajnimin e pilotëve studentë në një organizatë/shkollë të aprovuar të trajnimit.

Periodha e vlefshmërisë për kategorizimin e instruktorit është 4 vjet.

## **3. Parakushtet**

Aplikanti duhet të jetë bartës i licencës së pilotit të deltaplanit/paraglajdit prej të paktën dy (2) vjet, dhe duhet të ketë përfunduar të paktën 100 orë kohë të fluturimit dhe të ketë kryer së paku 10 fluturime të ndryshme përkatësisht në deltaplan apo paraglajd, nga të cilët dy (2) fluturime duhet të jenë më të gjata së 50 km.

## **4. Kërkesat e Trajnimit**

Për të marrë kategorizimin e Instruktorit piloti i Deltaplanit/Paraglajdit duhet të ketë kryer me sukses trajnimet teorike dhe praktike (fluturuese), në një organizatë/shkollë trajnimi të aprovuar nga AAC, për këtë qëllim.

Në rast të kryerjes së trajnimeve në një organizatë/shkollë jashtë Shqipërisë, aplikantët duhet të mbajnë parasysh që AAC do të pranojë trajnimet e kryera vetëm nga organizata/shkolla, të cilat janë aprovuar nga Autoriteti/Enti lëshues i licensave relevante në shtetin përkatës, mbi bazë të përpunshmërisë së programit të trajnimit me kërkesat e parapara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

Temat e trajnimit për Instruktor janë të përkthyer në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

## **5. Provimi Teorik**

Pas përfundimit të trajnimeve teorike, aplikantët duhet të kalojnë provimin teorik, i cili organizohet në AAC, për temat përkatëse të përshkruara në shtojcën 3 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave”.

## 6. Provimi praktik (skill test)

Pas përfundimit me sukses të provimit teorik, kandidati do t'i nënshtrohet provimit praktik, i cili do të drejtohet nga një Ekzaminues i autorizuar/pranuar nga AAC (shih kapitullin për Ekzaminuesit), jo më vonë se 12 muaj nga përfundimi i provimit teorik.

Pas marrjes së kategorizimit, privilegji i zotëruesit të licencës së pilotit të deltaplanit ose paraglajdit me një kategorizim instruktorit fluturimi është i kufizuar në kushtet e trajnimit teorik dhe praktik (fluturimit) për përfitim e licencës së pilotit të deltaplanit/paraglajdit nën mbikëqyrjen e një instruktorit me eksperiencë, deri sa zotëruesi të përfundojë sa më poshtë:

a) të paktën tri leksione të pavarura;

b) të asistojë të paktën 10 sesione trajnimi të veçanta me studentët.

Kufizimi hiqet nëse përmbushen kërkesat e specifikuara, bazuar në rekomandimin e instruktorit të fluturimit që ka mbikëqyrur mbajtësin.

## 7. Aplikimi

- I. Për provimin teorik dhe praktik aplikanti për kategorizimin e instruktorit do të dorëzojë në AAC, formën e aplikimit DAMO-GAT-FRM-04 “Aplikim për provim për marrjen e licencave dhe kategorizimeve”
- II. Për përfitim e kategorizimit të Instruktorit aplikanti do të dorëzojë në AAC, “Formën e aplikimit për Lëshimin e Licensës dhe kategorizimit”, DAMO-GAT-FRM-01
- III. Së bashku me formën e aplikimit do të bashkëlidhen dokumentat:
  - Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit teorik për marrjen e kategorizimit të instruktorit për Pilotë të Deltaplan/Paraglajd.
  - Vërtetimi I Kalimit me sukses të Provimit praktik sipas list kontrolleve përkatëse të instruktorit dhe tandem për Pilotin e Deltaplan / Paraglajdit, të firmosura nga Ekzaminuesi I aprovuar/pranuar nga AAC:



- “Lista kontrolluese e Ekzaminuesit për testin praktik për instruktor dhe tandem të pilotit për paraglajd”, DAMO-GAT-CHK-03
- “Lista kontrolluese e Ekzaminuesit për testin praktik për instruktor dhe tandem të pilotit për deltaplan”, DAMO-GAT-CHK-04
- Kopje e Librezës së Fluturimeve të Plotit ose Libreza e Fluturimeve të Instruktorit të fluturimit me pilotin aplikant.
- Nëse aplikanti ka kryer trajnimin teorik dhe praktik në një organizatë/shkollë të huaj sipas pikes 3, më sipër, në AAC, do të dorëzohet vërtetimi/certifikata e përfundimit me sukses të trajnimit nga organizata/shkolla e huaj (me detaje të trajnimit).
- Kopje e licenses së paraglajd/deltaplanit
- Certificate mjeksore LAPL
- Vërtetimi i pagesës për AAC

#### **8. Paraqitja e dokumenteve në AAC, për vazhdimësinë e vlefshmërisë së kategorizimit**

Për zgjerimin e vlefshmërisë së kategorizimit të Instruktorit piloti duhet të paraqesë në AAC çdo 4 vjet:

- Librezën e fluturimeve me hyrje të paktën 40 orëve fluturim sipas kategorizimit në deltaplan/paraglajd gjatë periudhës së vlefshmërisë, me kusht që çdo vit kalendarik ai/ajo të ketë përfunduar të paktën 10 orë kohë fluturimi;
- një certifikatë që provon se ai/ajo ka marrë udhëzim për njohuri teorike nga një organizatë e aprovuar për trajnimin e pilotëve të paraglajdit/deltaplanit;
- certifikata mjekësore.
- Vërtetimin e pagesës për AAC

Nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së kategorizimit piloti nuk përmbush kërkesat e specifikuara, kategorizimi pushon së qeni i vlefshëm deri sa të përmbushen kërkesat.



## Kapitulli III

### LËSHIMI I KATEGORIZIMIT TANDEM (MJETIT DYVENDËSH) PËR PILOTË TË PARASHUTËS (PARAGLAJDIT) DHE DELTAPLANIT

## **1. Mosha minimale**

Të paktën 18 vjeç.

## **2. Privilegjet**

Privilegji i mbajtësit të licencës së pilotit Tandem (D), janë për të fluturuar deltaplanin apo paraglajdin dy vendësh, me një person të dytë.

Periudha e vlefshmërisë për kategorizimin Tandem është 4 vjet.

## **3. Parakushtet**

Aplikanti për marrjen e kategorizimit Tandem (D), duhet të posedojë licencën e pilotit të deltaplanit/paraglajdit prej të paktën dy (2) vite dhe duhet të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej të paktën 100 orëve të fluturimit në deltaplan/paraglajd, dhe të ketë kryer të paktën dhjetë fluturime të ndryshme në deltaplan/paraglajd.

## **4. Kërkesat e Trajnimit**

Për të marrë kategorizimin Tandem (pilot i mjetit dyvendësh), piloti i Deltaplanit/Paraglajdit duhet të ketë kryer me sukses trajnimet teorike dhe praktike (fluturuese), në një organizatë/shkollë trajnimi të aprovuar nga AAC, për këtë qëllim. Në rast të kryerjes së trajnimeve në një organizatë/shkollë jashtë Shqipërisë, aplikantët duhet të mbajnë parasysh që AAC do të pranojë trajnimet e kryera vetëm nga organizata/shkolla, të cilat janë aprovuar nga Autoriteti/Enti lëshues i licensave relevante në shtetin përkatës, mbi bazë të përpunshmërisë së programit të trajnimit me kërkesat e parapara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

Temat e trajnimit për pilot Tandem (pilot i mjetit dyvendësh), janë të përshkruara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

## **5. Provimi Teorik**

Pas përfundimit të trajnimeve teorike, aplikantët duhet të kalojnë provimin teorik, i cili organizohet në AAC, për temat përkatëse të përshkruara në shtojcën 3 të Urdhrit të

Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave”.

## 6. Provimi praktik (skill test)

Pas përfundimit me sukses të provimit teorik, kandidati do t'i nënshtrohet provimit praktik, i cili do të drejtohet nga një Ekzaminues i autorizuar/pranuar nga AAC (shih kapitullin për Ekzaminuesit), jo më vonë se 12 muaj nga përfundimi i provimit teorik.

## 7. Aplikimi

I. Për provimin teorik dhe praktik aplikanti për kategorizimin e Tandem do të dorëzojë në AAC, formën e aplikimit sipas “Aplikim për provim për marrjen e licencës dhe kategorizimit”, DAMO-GAT-FRM-04

II. Për përfitimim e kategorizimit të pilotit Tandem aplikanti do të dorëzojë në AAC, “formën e aplikimit për Lëshimin e Licensës dhe kategorizimit”, DAMO-GAT-FRM-01.

III. Së bashku me formën e aplikimit do të bashkëlidhen dokumentat:

- Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit teorik për marrjen e kategorizimit Tandem për Pilotë të Deltaplan/Paraglajd.

- Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit praktik sipas list kontrolleve përkatëse të instruktorit dhe tandem për Pilotin e Deltaplan / Paraglajdit, të firmosura nga Ekzaminuesi I aprovuar/pranuar nga AAC:

- “Lista kontrolluese e Ekzaminuesit për testin praktik për instruktor dhe tandem të pilotit për paraglajd”, DAMO-GAT-CHK-03

- “Lista kontrolluese e Ekzaminuesit për testin praktik për instruktor dhe tandem të pilotit për deltaplan”, DAMO-GAT-CHK-04

- Kopje e Librezës së Fluturimeve të Pilotit ose Libreza e Fluturimeve të Instruktorit të fluturimit me pilotin aplikant.

- Nëse aplikanti ka kryer trajnimin teorik dhe praktik në një organizatë/shkollë të huaj sipas pikës 3, më sipër, në AAC, do të dorëzohet vërtetimi/certifikata e përfundimit me sukses të trajnimit nga organizata/shkolla e huaj (me detaje të trajnimit).



- Kopje e licenses së paraglajd/deltaplanit
- Certifikata mjeksore LAPL
- Vertetimi i pageses per AAC

**7. Paraqitja e dokumenteve në AAC, për vazhdimësinë e vlefshmërisë së kategorizimit**

Për zgjerimin e vlefshmërisë së kategorizimit tandem, piloti duhet të paraqesë në AAC çdo 4 vjet:

- Librezën e fluturimeve me hyrje të paktën 40 orëve fluturim sipas kategorizimit në deltaplan/paraglajd gjatë periudhës së vlefshmërisë, me kusht që çdo vit kalendarik ai/ajo të ketë përfunduar të paktën 10 orë kohë fluturimi;
- një certifikatë që provon se ai/ajo ka marrë udhëzim për njohuri teorike nga një organizatë e aprovuar për trajnimin e pilotëve të paraglajdit/deltaplanit;
- certifikatën mjekësore.
- Vërtetimin e pagesës për AAC

Nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së kategorizimit piloti nuk përmbush kërkesat e specifikuara, kategorizimi pushon së qeni i vlefshëm deri sa të përmbushen kërkesat.

## Kapitulli IV

### LËSHIMI I KATEGORIZIMIT TË PILOTIT TESTUES (T) PËR PILOTË TË PARASHUTËS (PARAGLAJDIT) DHE DELTAPLANIT

## **1. Mosha minimale**

Të paktën 18 vjeç.

## **2. Privilegjet**

Privilegji i mbajtësit të kategorizimit të pilotit testues (T), janë për të fluturuar në një Paraglajd/Deltaplan të një prodhimi të ri ose eksperimental për të testuar operimet e tij.

## **3. Parakushtet**

Aplikanti për marrjen e kategorizimit të pilotit testues, duhet të posedojë licencën e pilotit të deltaplanit/paraglajdit prej të paktën dy vjetësh dhe duhet të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 200 orëve të fluturimit në deltaplan/paraglajd, nga të cilat të paktën 100 orë të fluturimit në deltaplan përkatësisht në paraglajd i cili është i dedikuar për gara, si dhe të ketë kryer së paku 20 orë të fluturimit në secilin nga pesë llojet e ndryshme të deltaplanëve përkatësisht paraglajdëve.

## **4. Kërkesat e Trajnimit**

Për të marrë kategorizimin e piloti testues të Deltaplanit/Paraglajdit, pilotët aplikantë duhet të ketë kryer me sukses trajnimet teorike dhe praktike (fluturuese), në një organizatë/shkollë trajnimi të aprovuar nga AAC, për këtë qëllim.

Në rast të kryerjes së trajnimeve në një organizatë/shkollë jashtë Shqipërisë, aplikantët duhet të mbajnë parasysh që AAC do të pranojë trajnimet e kryera vetëm nga organizata/shkolla, të cilat janë aprovuar nga Autoriteti/Enti lëshues i licensave relevante në shtetin përkatës, ose nga prodhuesi i deltaplanëve përkatësisht paraglajdëve, apo në qendrën e specializuar për testimin e deltaplanëve përkatësisht paraglajdëve mbi bazë të përpunshmërisë së programit të trajnimit me temat e trajnimit për pilot testues të cilat janë të përshkruara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

## **5. Provimi Teorik**

Pas përfundimit të trajnimeve teorike, aplikantët duhet të kalojnë provimin teorik, i cili organizohet në AAC, në temat përkatëse të përcaktuara në shtojcën 3 të Urdhrit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".



## 6. Provimi praktik (skill test)

Pas përfundimit me sukses të provimit teorik, kandidati do t'i nënshtrohet provimit praktik, i cili do të drejtohet nga një Ekzaminues i autorizuar/pranuar nga AAC (shih kapitullin për Ekzaminuesit), jo më vonë se 12 muaj nga përfundimi i provimit teorik.

## 7. Aplikimi

I. Për provimin teorik dhe praktik aplikanti për kategorizimin e pilotit Testues do të dorëzojë në AAC, "Formën e aplikimit për provim për marrjen e licencave dhe kategorizimeve",

DAMO-GAT-FRM-04

II. Për përfundimin e kategorizimit të pilotit Testues aplikanti do të dorëzojë në AAC, "Formën e aplikimit për Lëshimin e Licensës dhe kategorizimit", DAMO-GAT-FRM-01.

III. Së bashku me formën e aplikimit do të bashkëlidhen dokumentat:

- Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit teorik për marrjen e kategorizimit Testues për Pilotë të Deltaplan/Paraglajd.

- Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit praktik për Pilotin Testues të Deltaplan / Paraglajdit, sipas list-kontrolleve të firmosura nga Ekzaminuesi I aprovuar/pranuar nga AAC:

  - DAMO-GAT-CHK-05

  - DAMO-GAT-CHK-06

- Kopje e Librezës së Fluturimeve të Plotit ose Libreza e Fluturimeve të Instruktorit të fluturimit me pilotin aplikant.

- Nëse aplikanti ka kryer trajnimin teorik dhe praktik në një organizatë/shkollë të huaj sipas pikës 3, më sipër, në AAC, do të dorëzohet vërtetimi/certifikata e përfundimit me sukses të trajnimit nga organizata/shkolla e huaj (me detaje të trajnimit).

- Kopje e licensës së paraglajd/deltaplanit

- Certificate mjeksore LAPL

- Vërtetimi i pagesës për AAC

#### **8. Paraqitja e dokumenteve në AAC, për vazhdimësinë e vlefshmërisë së kategorizimit**

Për zgjerimin e vlefshmërisë së kategorizimit të pilotit testues, piloti duhet të paraqesë në AAC çdo 4 vjet:

- Librezën e fluturimeve me hyrje të paktën 40 orë fluturim sipas kategorizimit në deltaplan/paraglajd gjatë periudhës së vlefshmërisë, me kusht që çdo vit kalendarik ai/ajo të ketë përfunduar të paktën 10 orë kohë fluturimi;
- një certifikatë që provon se ai/ajo ka marrë udhëzim për njohuri teorike nga një organizatë e aprovuar për trajnimin e pilotëve të paraglajdit/deltaplanit;
- certifikata mjekësore.
- Vërtetimin e pagesës për AAC

Nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së kategorizimit piloti nuk përmbush kërkesat e specifikuar, kategorizimi pushon së qeni i vlefshëm deri sa të përmbushen kërkesat.

## Kapitulli V

### LËSHIMI I KATEGORIZIMIT AKROBATIK (A) PËR PILOTË TË PARASHUTËS (PARAGLAJDIT) DHE DELTAPLANIT



## **1. Mosha minimale**

Të paktën 18 vjeç.

## **2. Privilegjet**

Privilegji i mbajtësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit me kategorizimin e fluturimit akrobatik (A) janë për te kryer fluturime akrobatike.

## **3. Parakushtet**

Aplikanti duhet të jetë bartës i licencës së pilotit të deltaplanit/paraglajdit prej të paktën dy (2) vjet dhe të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej të paktën 100 orëve të fluturimit në deltaplan/paraglajd.

## **4. Kërkesat e Trajnimit**

Për të marrë kategorizimin fluturimit Akrobatik, piloti i Deltaplanit/Paraglajdit duhet të ketë kryer me sukses trajnimet teorike dhe praktike (fluturuese), në një organizatë/shkollë trajnimi të aprovuar nga AAC, për këtë qëllim.

Në rast të kryerjes së trajnimeve në një organizatë/shkollë jashtë Shqipërisë, aplikantët duhet të mbajnë parasysh që AAC do të pranojë trajnimet e kryera vetëm nga organizata/shkolla, të cilat janë aprovuar nga Autoriteti/Enti lëshues i licensave relevante në shtetin përkatës, mbi bazë të përpunshmërisë së programit të trajnimit me atë të përcaktuar në Rregulloren shqiptare.

Temat e trajnimit për fluturimin akrobatik janë të përshkruara në Shtojcën 2 të Urdhrit të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

## **5. Provimi Teorik**

Pas përfundimit të trajnimeve teorike, aplikantët duhet të kalojnë provimin teorik, i cili organizohet në AAC, për lëndë përkatëse të përshkruara në shtojcën 3 të Urdhrit të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Parashutave".

## **6. Provimi praktik (skill test)**

Pas përfundimit me sukses të provimit teorik, kandidati do t'i nënshtrohet provimit praktik, i cili do të drejtohet nga një Ekzaminues i autorizuar/pranuar nga AAC (shih kapitullin për Ekzaminuesit), jo më vonë se 12 muaj nga përfundimi i provimit teorik.

## **7. Aplikimi**

I. Për provimin teorik dhe praktik aplikanti për kategorizimin Akrobatik do të dorëzojë në AAC, "Formën e aplikimit për provim për marrjen e licencave dhe kategorizimeve", DAMO-GAT-FRM-04

II. Për përfitimim e kategorizimit Akrobatik aplikanti do të dorëzojë në AAC, "Formën e aplikimit për Lëshimin e Licensës dhe kategorizimit", DAMO-GAT-FRM-01.

III. Së bashku me formën e aplikimit do të bashkëlidhen dokumentat:

- Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit teorik për marrjen e kategorizimit Akrobatik për Pilotë të Deltaplan/Paraglajd.
- Vërtetimi i Kalimit me sukses të Provimit praktik për kategorizimin Akrobatik të Pilotit të Deltaplan / Paraglajdit, të firmosura nga Ekzaminuesi I aprovuar/pranuar nga AAC.
- Kopje e Librezës së Fluturimeve të Plotit ose Libreza e Fluturimeve të Instruktorit të fluturimit me pilotin aplikant.
- Nëse aplikanti ka kryer trajnimin teorik dhe praktik në një organizatë/shkollë të huaj sipas pikes 3, më sipër, në AAC, do të dorëzohet vërtetimi/certifikata e përfundimit me sukses të trajnimit nga organizata/shkolla e huaj (me detaje të trajnimit).
